




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
20/DPK	01-2144/13
Dep.	Bi Prot.
Dep.	Prot No
Nr. llog.	Data
H-Q. sh. llog.	Datum
Nr. pague	Date
03	19-07-2013
PRISTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	19/07/2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z.Afrim BAJRAKTARI Drejtor i Prokurimit në Universitetin e Prishtinës
CC:	z.Esat KELMENDI Sekretar i Përgjithshëm në Universitetin e Prishtinës
NGA/OD/FROM:	z.Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion për Tenderin "Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative për nevojat e UP-së "Hasan Prishtina"



Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative për nevojat e UP-së "Hasan Prishtina", me nr. të prokurimit: 90400 13 078 111, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative për nevojat e UP-së "Hasan Prishtina" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka përgatitë “Njoftim Kontrate” me titullin: “Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative për nevojat e UP-së “Hasan Prishtina” me nr. prokurimi: 90400 13 078 111, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-ës më 04/07/2013, në Procedurë të Hapur.

Në “Njoftim Kontrate” të publikuar në KRPP më datë 04/07/2013, tek pika III.2.4 e rubrikës “Kapaciteti teknik dhe profesional”, pika 4 ku thuhet se: Pajisjet duhet të jenë Brand name (HP, Dell, IBM, Fuji Siemens, Cisco, Epson, Xerox, Canon, Panasonic, Ricon, etj. që janë Brand name), si dhe i njëjti përkufizim gjindet edhe tek “Dosja e Tenderit” tek Seksioni II, FLETA E TË DHËNAVE TË TENDERIT (FTD), pika 9.1 “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale” nën-pika 3. e cila gjithashtu përkufizon se: Pajisjet duhet të jenë Brand name (HP, Dell, IBM, Fuji Siemens, Cisco, Epson, Xerox, Canon, Panasonic, Ricon, etj. që janë Brand name) nuk janë në përputhshmëri me rregullat e prokurimit.

Specifikimet Teknike që duhet t'i përmbajnë pajisjet e Teknologjisë Informative janë të specifikuara në atë mënyrë që vetëm një prodhues mund t'i posedoj. Në Dosjen e Tenderit, ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, pika 1, janë dhënë këto specifika:

Procesori: Intel Core i3-3220 3.3 Ghz, 3 MB cache, 2 cores

Chipseti: H61 Express apo me i avancuar

Memorje: 4GB 1600 Mhz DDR3 SDRAM

HDD: 500GB 7200rpm SATA 3.0 Gb/s

Lexuesi optik: SATA Super Multi DVD-writer

Kartela grafike: Intel HD Basic e integruar

Monitor: 1, të njëjtit prodhues me rezolucion minimum 1600x900 me porte 1x VGA dhe 1x DVI-D, diagonale minimum 20 Inç (50.8 cm). Kontrasti Statik 600:1 Kontrasti dinamik 3000000:1

Kartela e rrjetit: E integruar Intel Gigabit

Porte shtese: 10x USB 2.0; 1RJ-45; 1 DVI-D; 1 VGA; 1 Headphone; 2 Microphone; 1 Audio in; 1 Audio out;

Ports note 4 of 10 USB 2.0 ports are internal.

Mausi Optik nga i njejti prodhues.

Tastiera USB Standard Value Keyboard

Specifikat e lartë shënuara janë në përputhshmëri të plotë vetëm me prodhuesin HP

Specifikimet Teknike që duhet t'i përmbajnë pajisjet e Teknologjisë Informative janë të specifikuara në atë mënyrë që vetëm një prodhues mund t'i posedoj. Në Dosjen e Tenderit, ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, pika 13, janë:

Printer A4

Shpejtësia e printimit b/z: deri ne 18 flete A4

Cikli i punës mujore: deri 5000 fletë për muaj

Fleta e pare: 7.8 sec

Kualiteti i printimit: deri ne 2400 x 600 dpi

Rezolucioni i printimit : 600 x 600 dpi

Gjuhet: Host-based printing

LCD: Jo

Koneksionet: 1 Hi-Speed USB 2.0

Specifikat e lartë shënuara janë në përputhshmëri të plotë vetëm me prodhuesin CANON.

Me emërtimet e brendeve dhe specifikimet autentike të një prodhuesi konkret, mund të favorizohet ndonjë operator ekonomik dhe të diskriminohet ndonjë tjetër. Bazuar në legjislacionin e vendit dhe ligjeve në fuqi, një gjë e tillë nuk është e lejuar dhe nuk i jep hapësirë konkurrencës së lirë dhe legale.

Konsiderojmë se një shkelje e tillë, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Opinionin është i përpiluar në bazë të ligjit nr.03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit i mbështetur edhe nga ligji nr.04-L/042 për Prokurimin Publik

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë që bien ndesh me Nenin 7, Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi; nenin 27 Dosja e Tenderit; nenin 28 Specifikimet teknike

Me respekt!

